



VENDIM

Nr. 33, Datë 09.03.2016

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“PHOENIX PETROLEUM SH.A. NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 105, 107; nenit 22 pika 2 gërma “ç”; nenit 83 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; neneve 4, pika 1, gërma “ç”; 8, 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma “e” dhe nenin 10, pika 1 të Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror“, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria PHOENIX PETROLEUM sh.a. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të shoqërisë PHOENIX PETROLEUM sh.a.,

Konstatohet se:

- Format dhe Dokumentacioni për Aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, gërma “d”/i, d/ii, d/iv, d/v, d/vi); është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale (neni 9, pika 1, gërma e/i, e/ii, e/iii, e/v, e/vi), janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik për llojin e licensës (neni 9, pika 2, gërma e/i), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentet specifike për llojin e licensës (Neni 9 pika 2 gërma e/ii, e/iii), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për liçensimin e shoqërisë“”PHOENIX PETROLEUM” sh.a në aktivitetin e tregëtimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.